

**NDRYSHIMET E PROPOZUARA NË RREGULLOREN PËR PROCEDURAT DHE
AFATET PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN, RINOVIMIN OSE
HEQJEN E LICENSAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 109, DATË 29.06.2016, E
NDRYSHUAR**

- Kudo në rregullore, togfjalëshi “*i deleguari përgjegjës*”, të zëvendësohet me “*përfaqësues ligjor*”.
- Në nenin 3, “*Përkufizime*”, përkufizimet përkatëse për “*Licencë*” dhe “*I licencuar*” janë në një paragraf, ndaj me qëllim identifikimin e tyre propozojmë që përkufizimi “*I licencuar*”, të vendoset një paragraf më poshtë.
- Në nenin 7, ***Delegimi i të drejtave të aplikuesit, behen keto ndryshime:***
 - **pika 1** ndryshon si vijon:
 1. *Aplikuesi mund të caktojë një person fizik ose juridik si përfaqësues ligjor, i cili do ta përfaqësojë aplikuesin në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me aplikimin, brenda kompetencave të dhëna në aktin e përfaqësimit të depozituar në ERE.*
 - **pika 2** shfuqizohet.
- Në nenin 8, ***Paraqitja e aplikimit, behen keto ndryshime:***
 - **pika 2** ndryshon si vijon:
 2. *Aplikuesi plotëson formatin përkatës sipas Aneksit A të kësaj rregulloreje, dhe e depoziton atë në ERE, së bashku me dosjen e aplikimit. Në bazë të specifikimeve të plotësuara në Aneksin A, struktura përgjegjëse për financat në ERE i dërgon elektronikisht faturën përkatëse aplikuesit. Në rast se aplikuesi nuk kryen pagesën, aplikimi i tij nuk merret në shqyrtim. Nga dita që aplikuesi kryen pagesën, Bordi i ERE-s merr vendim për fillimin ose jo të procedurës brenda 12 ditëve pune. Pagesa e aplikimit është e pakthyeshme.*
 - **pika 5**, ndryshon si vijon:
 5. *Dokumentacioni teknik sipas tipit të licencës duhet të jetë i hartuar dhe sigluar nga individ apo person juridik i pajisur me licencë profesionale përkatëse sipas legjislacionit në fuqi (ing. elektrike, ing. ndërtimi, ing. mekanike, ekspertë kontabël, ing. hidroteknikë etj.). Dokumentacioni që depozitohet në formën e deklaratës nga shoqëria, duhet të jetë i sigluar dhe vulosur sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.*
- Në nenin 9, ***Formati dhe dokumentacioni për aplikim***, bëhen ndryshimet si vijon:

- **Te germa “b”**, *Të dhëna identifikuese të aplikuesit, te pika 1 e tabelës, “Numri i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit, zëvendësohet me Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)”*.
 - **Te germa “b”**, *“Të dhëna identifikuese të aplikuesit”, te pika 2 dhe 4 e tabelës shtohet dhe adresa e e-mailit.*
 - **Te germa “c”**, *“Të dhëna për aplikuesin”, pika 4 e tabelës, shfuqizohet.*
- **Në nenin 9, *Formati dhe dokumentacioni për aplikim, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, germa “d”***, ndryshon si vijon:
 - d. *Vërtetim që shoqëria dhe administratori/administratorët e saj, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). Këto vërtetime do të paraqiten për selinë qendrore dhe çdo vend tjetër të ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, që lidhet, sipas rastit, me ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkon të licencohet subjekti, apo me veprimtarinë e licencuar. Në rast se shoqëria do të caktojë një përfaqësues ligjor, ajo duhet të depozitojë prokurën ose autorizimin përkatës për përfaqësimin, si dhe vërtimet (nga prokuroria dhe gjykata) që përfaqësuesi ligjor nuk është i përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë.*
- **Në nenin 9, *“Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, pika 3, Dokumentacioni financiar dhe fiskal, bëhen ndryshimet si vijon:***
 - **germa “b”** ndryshon si vijon:
 - b. *Bilanci financiar i tri viteve të fundit/ose kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit), i audituar (kur kerkohet nga ligji).*
 - **germa “c”** ndryshon si vijon:
 - c. *Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.). Për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, aplikuesi duhet të përcaktojë dhe kapitalin financiar (të shprehur në vlera monetare) të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë, bazuar në dokumentacion vërtetues të aftësisë dhe/ose mbështetjes financiare.*
 - **germa “d”** shfuqizohet.
- **Në nenin 9, pika 4.1.4, *“Dokumentacioni tekniko ekonomik” germa “c”***, ndryshon si vijon:
 - c. *Oponencën teknike të projektit të kryer nga AKBN ose nga një person fizik apo juridik i licencuar.*

- Në nenin 9, pika 4.1.5 “*Lejet nga institucione te tjera*”, shtohet germa **d**, me pëmbajtje si vijon:
 - d. Leja e ndërtimit.*
- Në nenin 9, pika 4.3.4 “*Dokumentacioni tekniko ekonomik*”, germa “**c**”, ndryshon si vijon:
 - c. Oponencën teknike të projektit të kryer nga AKBN ose nga një person fizik apo juridik i licencuar.*
- Në nenin 9, pika 4.5 “*Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike*”, behen keto ndryshime:
 - Në germen “**a**” hiqet kolona me emërtimin *Numri i shtyllave*.
 - Në germen “**f**”, togfjalëshi “planet e investimeve” zëvendësohet me “planet e zhvillimit të rrjetit”,
- Në nenin pika 4.6 “*Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike*”, bëhen ndryshimet si vijon:
 - Në germen “**b**” togfjalëshi “planet e investimeve” zëvendësohet me “planet e zhvillimit të rrjetit”
 - Në germen “**i**”, në rreshtin e katërt, *Aktiviteti*, hiqen specifikimet për *buxhetore*.
- Në nenin 9, pika 4.7, “*Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike*”, bëhen ndryshimet si vijon:
 - germa “**b**” ndryshon si vijon:
 - b. kapitali financiar për të mbuluar sasinë e parashikuar të energjisë (sipas përcaktimeve të germës “a” të kësaj pike të rregullores) dhe të çmimit mesatar të parashikuar (nga vetë aplikuesi). Dokumentacioni ligjor vërtetues për disponimin e shumës nga aplikuesi (vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare) duhet të mbulojë 3 muaj të kësaj vlere.*
 - Në germen “**c**” fjala “*sigurimin*” zëvendësohet me fjalen “*furnizimin*”.
 - germa “**d**” ndryshon si vijon:
 - d. informacion tekniko-financiar lidhur me përmbushjen e këtyre kontratave (sasia e energjisë, subjekti me të cilin është lidhur kontrata, afati për përmbushjen e kontratës, problematike të mundshme etj).*
 - germa “**e**”, ndryshon si vijon:
 - e. Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi. Ky sistem duhet të jetë kompatibël me sistemin e operatorit të rrjetit (OST ose OSSH). Për këtë aplikuesi duhet të sjellë konfirmimin e operatorit të rrjetit që sistemi IT që ai disponon është kompatibël.*

- Në germën “h”, shtohet dhe një nenkategori në tabelë për linjën 220 kV.
- Ne nenin 9, pika 4.8, *Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike germa “b”*, shfuqizohet.
- Në nenin 10, *“Shqyrtimi i Aplikimit”*, bëhen këto ndryshime:
 - Në pikën 7, pas grupit të fjaleve *“brenda 1 muaji nga marrja”* shtohet fjala *“dijeni”*
 - Në pikën 8, pas grupit të fjaleve *“ERE publikon”* shtohet grupi i fjaleve *“në faqen e saj zyrtare të internetit”*.
 - pika 12, ndryshon si vijon:

12. Me kërkesë me shkrim, aplikuesi mund të kërkojë që të mbahen konfidenciale informacione ose dokumente të depozituara prej tij në kuadër të aplikimit, që mund t'i shkaktojnë atij dëm tregtar. Ky dokumentacion duhet të specifikohet të prej tij, së bashku me arsyet e mosbërjes publike. Përndryshe konsiderohet se kërkuesi nuk e kërkon një kufizim të tillë. Kjo kërkesë, në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi mbi informacionin konfidencial dhe të drejtën e informimit, do të mbahet në konsideratë në vijim, në rast të interesit të palëve të treta për të aksesuar dokumentacionin e aplikimit.
- Në nenin 14, *Pranimi ose Refuzimi për Licensim i Aplikuesit*, shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:
 - 8. Në rast se i licencuari humbet dokumentin origjinal të licencës të lëshuar nga ERE, ai mund të bëjë kërkesë në ERE për lëshim duplikatë licence, kundrejt një pagesë prej 15 000 lekësh. Në këtë rast aplikuesi dorëzon kërkesën e tij në ERE, së bashku me Aneksin A, të plotësuar sipas specifikimeve përkatëse. Struktura përgjegjëse për financat në ERE i dërgon të licencuarit elektronikisht faturën. Të licencuarit do t'i lëshohet dublikata e licencës vetëm pasi të vërtetohet se ai ka kryer pagesën përkatëse sipas faturës që t'i dërgohet nga ERE.
- Në nenin 16, *Rinovimi i licencës*, bëhen këto ndryshime:
 - Në pikën 1, fjala *person* të zëvendësohet me *i licencuar*.
 - pas pikës 7, shtohet pika 8, me përmbajtje si vijon:

8. Në rast se i licencuari nuk paraqet në ERE aplikim për rinovimin e licencës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, ose ERE merr vendim për refuzimin e kërkesës së të licencuarit për rinovim të licencës, kjo e fundit e humbet vlefshmërinë me përfundimin e afatit të kohëzgjatjes së saj dhe hiqet nga regjistri i të licencuarve të ERE-s. Në këto rrethana, në rast të interesit për të ushtruar sërish veprimtarinë, duhet të paraqitet aplikim për licensim nga e para, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
- Aneksi A, *“Formati për pagesën për regjistrim dhe procedim të një aplikimi”*

ndryshon si vijon:

ANEKSI A
Formati për pagesën për regjistrim dhe procedim të një aplikimi
(Për t'u plotësuar nga aplikuesi)

Bazuar në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, kërkoj nga ERE plotësimin e faturës përkatëse sipas specifikimeve të mëposhtme në tabelë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për sektorin e energjisë elektrike dhe të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”.

Emri i subjektit						
Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)						
Veprimtaria	Licencim	Modifikim	Rinovim	Transferim	Njohje e licencës	Dublikatë licence
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prodhimi i energjisë elektrike	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	250 000 lekë <input type="checkbox"/>	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	500 000 lekë <input type="checkbox"/>		15 000 lekë <input type="checkbox"/>
Operimi i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike	1 000 000 lekë <input type="checkbox"/>	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	1 000 000 lekë <input type="checkbox"/>	1 000 000 lekë <input type="checkbox"/>		15 000 lekë <input type="checkbox"/>
Operimi i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike	1 000 000 lekë <input type="checkbox"/>	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	1 000 000 lekë <input type="checkbox"/>	1 000 000 lekë <input type="checkbox"/>		15 000 lekë <input type="checkbox"/>
Furnizimi i energjisë elektrike	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	250 000 lekë <input type="checkbox"/>	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	15 000 lekë <input type="checkbox"/>
Operimi i tregut të energjisë elektrike	1 000 000 lekë <input type="checkbox"/>	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	1 000 000 lekë <input type="checkbox"/>	1 000 000 lekë <input type="checkbox"/>		15 000 lekë <input type="checkbox"/>
Sistemet e mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike	1 000 000 lekë <input type="checkbox"/>	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	1 000 000 lekë <input type="checkbox"/>	1 000 000 lekë <input type="checkbox"/>		15 000 lekë <input type="checkbox"/>
Tregtimi i energjisë elektrike	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	250 000 lekë <input type="checkbox"/>	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	500 000 lekë <input type="checkbox"/>	15 000 lekë <input type="checkbox"/>

Unë, aplikuesi, me plotësimin dhe depozitimin e këtij formati në ERE, së bashku me dosjen e aplikimit, njoh detyrimin për të paguar faturën që do të lëshojë ERE elektronikisht, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Për aplikuesin

(emër mbiemër, nënshkrim)